

31.10.2025

Procesverbal - Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “ Blerje Mates Bilanci magnetik”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV Mates uji 38421100)

Vlera e fondit limit: : 4.995.250 (kater milion e nenteqind e nentedhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë) pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar me VKM-në nr.714, datë 24.11.2021 autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;përkatësisht në **99.905** (nentedhjetë e nente mijë e nenteqind e pesë) leke*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomiko-financiar

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006.

”Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2025).**

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime).

2.2.4. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe

përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 si dhe vendimeve respektive të Këshillave Bashkiakë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

3. Kapaciteti teknik:

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit .

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori zyrtar për të gjithë mallrat objekt prokurimi kjo e vërtetuar nepermjet dokumentave origjinal ose noterizuar si perfaqesues i kompanise prodhuese për të gjithë mallin/mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizimi distributori, OE duhet të paraqesë dokumentacionin, që vërteton se OE në fjale është perfaqesuesi zyrtar për Republikën e Shqipërisë. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si, numri i telefonit, faksi, posta elektronike dhe faqja e internetit, të dhëna të nevojshme për autoritetin kontraktor, në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 77 e LPP, si dhe nenin 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi ka të bëjë me informacion të nevojshëm se ku prodhohet malli dhe mundësi reale për të bërë furnizimin, nepermjet autorizimit që i jepet operatorit ekonomik ofertues

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog nga kompania prodhuese për të gjitha mallrat objekt prokurimi, ku të vërtetohet përputhjen e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenin 40, pika 6/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi katalogu i mallit tregon karakteristikat teknike të produkteve, me qëllim përmbushjen e të gjitha kërkesave dhe specifikimeve teknike.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatë **DVGW / WRAS ose ekuivalente**, të aprovimit për përdorimin e ujit të pijshëm për të gjithë matësat, të lëshuar nga një trup i certifikuar ndërkombëtar apo kombëtar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Referuar faktit se në preventivin objekt prokurimi kërkohen mallra të cilat do kenë kontakt me të drejtpërdrejtë me ujin e pijshëm(furnizim jetik për qytetarin) kërkohet që cilësia të jetë e lartë e standarteve të kërkuara me qëllim mosndikimin e faktorëve të jashtëm në cilësinë e ujit.

2.3.5 Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në formën e një table, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës.

Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr	Emertimi i produkteve	Emertimi kompanise prodhuese, adresa , ëeb-siti	Emertimi i katalogut	Referenca ne katalogje/	Shënimet
				KOD I produktit ose nr. Faqes ne katalog	

Emërtimi I produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK.

-Emri, Adresa dhe ëeb-site i kompanise prodhuese ose distributor i autorizuar, me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në ofertim.

-Referenca në katalogje, kodi i produktit të plotësohet (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr,i faqes)duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut në katalogun përkatës ku AK mund të gjejë specifikimet teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK.

2.3.5 Operatorët Ekonomik në momentin e hapjes së ofertave, duhet të paraqesin një mostër për matësin Dn 150. Mostra duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim.*Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

Argumentim: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të vlerësojë mallrat objekt procedure prokurimi nëse janë në përputhje me specifikimet teknike dhe gjykon se prezantimi i mostrave ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Kriteri i kërkuar në lidhje me paraqitjen e mostrave, është vendosur në përputhje me piken 6/a, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.bazuar në Udhëzimin Nr. 2 datë 02.05.2019. Faza e paraqitjes së mostrave i shërben Autoritetit Kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen, me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga ana jonë. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje ne piken 6 te nenit 40 te të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se:6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

II. ARGUMENTIM

MBI SPECIFIKIMET TEKNIKE

*Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*